



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË
Nr. 554 Prot. Tiranë, më 04/06/2014

Lënda: Dërgohet rekomandim për rishikimin e kontratës tip mbi “Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë”.

Drejtuar: **Z. Petrit AHMETI**
Kryetar i Bordit të Komisionerëve
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

TIRANË

I Nderuar Z. Ahmeti,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si institucion i pavarur në ushtrimin e detyrës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Kompetencat kryesore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të shqyrtojë ankesa, në lidhje jo vetëm me sektorin publik, por edhe me sektorin privat dhe individët, në fushën e punësimit, arsimit si dhe *në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve* lidhur me një listë jo-shteruese të shkaqeve të diskriminimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatim të nenit 32 pika 1 (a) të ligjit “Për Mbrotjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se “Komisioneri ka kompetencë të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj”, ka shqyrtuar ankesën e shtetasë A.Ç, kundër CEZ Shpërndarje sh.a në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të gjinisë, shtatzënisë, gjendjes martesore dhe gjendjes civile.

i. Përbledhje e fakteve të çështjes së paraqitur pranë KMD

Me datë 02.04.2013 shtetasja A.Ç ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes kërkesës nga QNLQ, një organizatë jo fitimprurëse aktive në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të grave nga dhuna e diskriminimi. Subjekti ankues, shtetasja A.Ç, me



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tirana
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

gjendje civile e divorcuar¹, shtatzënë dhe nënë e dy fëmijëve lënë asaj për kujdes me vendim gjyqësor, ka raportuar ndërprerjen e shërbimit të furnizimit me energji elektrike, edhe pse ka marrë përsipër të gjitha detyrimet që burojnë nga kontrata dhe ka paguar rregullisht detyrimet. Zgjidhja e martesës dhe rregullimi i pasojave të saj është vendosur në vitin 2011, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë. Dy ish-bashkëshortët vazhdojnë të jenë në procese gjyqësore për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore në Gjykatën e Lartë. Duke shfrytëzuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë në lidhje me pjesëtimin e pasurisë, dhe duke mos patur një titull ekzekutiv të këtij vendimi, ish-bashkëshorti, në cilësinë e kryefamiljarit përfshirë efekt të kontratës-tip, sipas të cilit vetëm ai njihet si kontraktues i këtij shërbimi, ka kërkuar pezullimin e përkohshëm të kontratës me CEZ Shpërndarje sh.a. Ky i fundit, me marrjen e kërkeshës përfshirë pezullim furnizimi me energji dhe në zbatim të kontratës tip mbi “*Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë*”, ka vepruar menjëherë në përgjigje të kësaj kërkeshë, duke zgjidhur kontratën me pasojë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të kësaj banese. Kështu, në ndihmë të këtyre cënimive shërbejnë edhe dispozitat ligjore apo nënligjore ose praktikat e krijuara nga institucionet që ofrojnë shërbime përmes kontratave tip.

Duhet theksuar fakti se, pas zgjidhjes së martesës, shtetësja A.Ç ka kërkuar të lidh kontratën përfurnizimin me energji elektrike në emër të saj, deri në përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë, por CEZ Shpërndarje sh.a ka refuzuar të ofrojë këtë shërbim, duke pretenduar se kontrata është vetëm në emrin e kryefamiljarit dhe ata njohin vetëm atë si kontraktues. Në ketë mënyrë, kërkesat e përsëritura të shtetasës A.Ç përfurnizimin me energji elektrike nuk kanë gjetur përgjigje pozitive, duke e kthyer banesën në një vend të papërshtatshëm banimi. Kjo ka përmbusur synimin e ish-bashkëshortit të saj përlargimin nga shtëpia. Ndërkohë, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit dhe përmoszbatim vullnetar të tij nga ish-bashkëshorti, A.Ç duhet të ishin marrë masat përzbatimin e këtij vendimi. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se raste të abuzimeve nga kryefamiljar, në cilësinë e titullarit kontraktues, mund të ndodhin edhe kur nuk ka zgjidhje martese. Kështu, nëse nuk do të kishte një vendim gjyqësor përzgjidhje martese, çfarë shkaku tjetër mund të mbahet parasysh nga CEZ Shpërndarje sh.a, për ndërprerjen apo pezullimin e kontratës?

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në fjalë, me vendim nr. 93, datë 30.09.2013, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të znj. A.Ç, nga ana e CEZ Shpërndarje dega Tiranë, për shkak të gjinisë, shtatzenisë, gjendjes martesore dhe civile dhe i ka rekomanduar CEZ Shpërndarje dega Tiranë, të marrë të gjitha masat përfundimtare me energji elektrike të banesës znj. A.Ç si dhe ka vendosur konstatimin e diskriminimit të tertiortë të znj. A.Ç, nga Enti Rregullator i Energjisë, pasi kontrata e furnizimit me energji elektrike përfundon, nuk parashikon aksesin e barabartë që duhet të kenë bashkëshortët apo ish bashkëshortët, si dhe nuk parashikon trajtim të veçantë përgatitë shtatzëna dhe fëmijët në përfundimin e shërbimit të furnizimit me energji elektrike.

ii. Parashikimet e Kontratës së Ofrimit të Shërbimeve

Në kontratën tip “Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjare”, të miratuar nga ERE, *nuk parashikohet asnjë përkufizim i termit “klient*

¹ Vendimi nr. 4184/ 20.05.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.



familjar". Megjithatë, kategoria "klient familjar" e parashikuar nga vetë kontrata si kategori e veçantë, duhet interpretuar në mënyrë të tillë që të përfshijë klientin si pjesë e një familjeje, që është përfitues i shërbimit, dhe jo një individ të vetëm. Përkundrazi, nga ana e autoriteteve të CEZ Shpërndarje sh.a, termi interpretohet në kundërshtim me vetë terminologjinë "familjar", duke e kufizuar shërbimin, si dhe të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga ai, vetëm ndaj individit, në rastin konkret bashkëshortit.

Realisht, kontrata përbushet duke realizuar detyrimet nga të dy bashkëshortët, duke paguar rregullisht së bashku detyrimet për energjinë elektrike. Ndaj, fakti që kontrata lidhet vetëm në emër të bashkëshortit, nuk do të thotë mohim i të drejtave të bashkëshortes dhe fëmijëve të tyre. Për më tepër, lidhur me rastin në fjalë, shtetësja A.Ç ka paguar rregullisht të gjitha detyrimet nga CEZ Shpërndarje sh.a, ndërkohë që ish-bashkëshorti i saj ishte larguar nga shtëpia që në vitin 2007.

Për këtë arsy, *gjykojmë se parashikimet e kontratës tip duhen rregulluar në drejtim të përkufizimit të termave edhe kushteve që duhen përbushur, me qëllim shmangien e situatave të trajtimit të pabarabartë.*

Duhet theksuar gjithashtu fakti se, në dukje kontrata për klientët familjarë paraqitet neutrale për sa i përket se kush është kryefamiljari, por në realitetin shqiptar dihet që me këtë "rol" janë veshur përgjithësisht meshkujt, që do të thotë se kontratat familjare janë të nënshkruara përgjithësisht nga kryefamiljarët meshkuj.

Vlerësojmë se, për kategorizimin e një individi si "klient familjar", faktorët familjar, si bashkëshortja duhet të gjejnë gjithashtu njohjen formale në kontratën tip. Në këtë mënyrë, *përfitues të shërbimit në rastin e kategorisë "klient familjar" janë si individi ashtu edhe anëtar të familjes së tij*. Në këtë kuptim, kontrata ka mangësi në drejtim të përkufizimit të termave të saj duke u bazuar në zbatimin e saj në një kuptim të cunguar të termit. Ky kufizim në interpretim dhe zbatim ka krijuar situatën e pabarabartë midis të drejtave të dy ish-bashkëshortëve, në lidhje me përfitimin e shërbimit nga ana e CEZ Shpërndarje sh.a.

Subjekti CEZ Shpërndarje sh.a nuk e njeh aksesin e barabartë që duhet të kenë bashkëshortët apo ish-bashkëshortet për të kontraktuar shërbimin e energjisë elektrike. Konkretnisht, CEZ Shpërndarje sh.a, ndërpërt energjinë elektrike me kërkesë të Klientit Familjar, duke nënkuptuar nënshkruesin e kontratës, por nuk do të dijë asgjë për familjen e tij. Nuk ka asnjë arsy që kontrata të mos vazhdojë e rilidhur në emër të bashkëshortes, sa kohë që ajo me fëmijët banojnë aty.

Aktet ndërkombëtare garantojnë parimin e barazisë dhe ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, lidhur me të drejtën për strehim dhe për të pasur një banesë të përshtatshme si një e drejtë themelore për një standard adekuat dhe njerëzor jetese, nga ku mund të përmendet:

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut në nenin 25 e përfshin të drejtën për strehim si pjesë të së drejtës për një standard adekuat jetese; *Pakti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore* në nenin 10 thekson se një mbrojtje dhe ndihmë sa më e gjerë duhet t'i jepet familjes, në nenin 11, pika 1 garantohet e drejta për strehim gjithashtu si pjesë e të drejtës për një standard adekuat jetese, ndërsa në nenin 12 trajtohen çështje të standardeve lidhur me shëndetit. Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, thekson se "e drejta e njeriut për strehim të përshtatshëm... ka



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

një rëndësi shumë të madhe për të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore".² Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Protokolli 12, nen 1, parashikon ndalimin e përgjithshëm të diskriminimit. Konventa e OKB për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave - CEDAW në nenin 2 parashikon që shtetet palë: (d) të mos ndërmarrin asnjë veprim ose praktikë diskriminuese ndaj grave dhe të sigurojnë që autoritetet dhe institucionet publike të veprojnë në përputhje me këtë detyrim; (e) të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave nga çdo individ, organizatë apo ndërmarrje; (f) të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për të ndryshuar ose shfuqizuar ligjet ekzistuese, rregulloret, zakonet dhe praktikat të cilat përbëjnë diskriminimin ndaj grave. Në nenin 14 kemi të drejtën për të pasur kushte jetese të përshtatshme, veçanërisht lidhur me strehimin, shërbimin sanitari, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikacionet. Në nenin 15 kemi: në paragrafin e parë, parimin e barazisë përparrë ligjit; në paragrafin e dytë parashikohet se "shtetet palë do t'i njojin grave, në fushën civile, zotësi juridike të njëjtë me atë të burrave dhe mundësi të njëjta për ta ushtruar këtë zotësi. Shtetet palë do t'i njojin grave në mënyrë të veçantë të drejta të barabarta për të lidhur kontrata dhe për të administruar pasuri dhe do t'i trajtojnë ato njësoj në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore"; 3. Shtetet palë bien dakord se çdo kontratë ose çdo dokument tjetër privat i çfarëdo lloji, që ka për efekt juridik të synojë kufizimin e zotësisë juridike të grave, duhet të konsiderohet i pavlefshëm; 4. Shtetet palë do t'i njojin burrave dhe grave të drejta të njëjta lidhur me legjislacionin që trajton të drejtën e personave për të lëvizur lirisht, si dhe për të zgjedhur vendbanimin dhe banesën e tyre". Ndërsa në nenin 16 të CEDAW parashikohet se "1. Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëni familjare. Në mënyrë të veçantë, do t'i sigurojnë grave mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave: h) Të drejtat e njëjta për secilin prej bashkëshortëve lidhur me pronësinë, fitimin, administrimin, gjëzimin dhe disponimin e pasurisë, si falas ashtu edhe me pagesë". Gjithashtu, *Karta Sociale Europiane (e rishikuar)* garanton të drejtën e strehimit/banimit.

Nga pikëpamja gjinore e akteve nënligjore me të cilat procedon CEZ Shpërndarje sh.a., përvëç emërtimit "klient familjar", nuk ka asnjë dispozitë tjetër që mbron familjen nga mungesa e aksesit ndaj energjisë eklektike.

Në kontratën tip të miratuar me vendim të ERE "**Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjare**", në pikën 5.3, parashikohet se "sipas të njëjtave përcaktimeve, Klienti mund të kërkojë pezullimin e kontratës për një periudhë të caktuar sipas kërkesës së tij. Furnizuesi do të bëjë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike sipas procedurave dhe kushteve të përcaktuara për këtë qëllim. Klienti do bëjë kërkesë për rilidhjen e energjisë pranë çdo përfaqësie të Furnizuesit".

Kështu, në këtë klauzolë nuk përcaktohen subjektit që përfshihen tek "klienti", nuk parashikohet një përkufizim për të si dhe nuk përcaktohet asnjë masë që mund të mbrojë të drejtat e barabarta mes familjarëve kontributorë për pagesën e energjisë elektrike. Pra, **në këtë kontratë nuk ka një dispozitë që mbron familjen nga mungesa e aksesit me energji elektrike** dhe në rastin e abuzimit që bën titullari i kontratës me të drejtën e tij si palë kontraktuese, nuk ka asnjë masë mbrojtëse për anëtarët e tjerë të familjes.

² Komiteti i OKB-së për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Koment i Përgjithshëm 4.



Lidhur me lirinë e “*klientit*” si titullar i kontratës për pezullimin e saj, nuk ka një dispozitë e cila të parashikojë mënyrën se si do të vlerësohet kërkesa e tij për ndërprerjen/pezullimin e energjisë elektrike. Në këtë mënyrë, vullneti i titullarit të kontratës trajtohet si absolut, madje edhe kur ai e paraqet këtë kërkesë në mënyrë abuzive. Kështu, nga kjo klauzolë, konstatojmë se kontrata nuk përcakton asnjë kusht për lirinë e titullarit kontraktues për ndërprerjen apo pezullimin e saj, duke i dhënë mundësi këtij të fundit, që të abuzojë me këtë të drejtë.

Gjithashtu, në kontratë nuk është parashikuar asnjë detyrim për respektimin e familjes, fëmijëve, dhe grave shtatzëna që banojnë nën të njëjtën strehë me titullarin e kontratës.

Nga dispozitat e kontratës tip të miratuar me vendim të ERE **“Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjare”**, KMD ka konstatuar se, cënohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit në fushën e të mirave dhe shërbimeve, parimi i barazisë gjinore si dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës të sanksionuar nga Kushtetuta e R.Sh ku proklamohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit [neni 18], garantohet e drejta për të mos iu nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues [neni 25], garantohet mbrojtje të veçantë për familjen, fëmijët dhe gratë shtatzëna [neni 53 dhe 54]; Kodi i Familjes në nenin 2 parashikon interesin më të lartë të fëmijës si një ndër parimet e përgjithshme që rregullon marrëdhëniet familjare³ si dhe parashikon dispozita lidhur me të drejtën e banimit siç është neni 139 ku, ndër masat e përkohshme, në procesin e zgjidhjes së martesës dhe kur shihet e arsyeshme nga gjykata, renditet edhe sigurimi i banimit, dhe nenin 153 lidhur me të drejtën e përdorimit të banesës familjare pavarësisht se pronë e cilët bashkëshort është; Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴, ligji 9970/2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” në nenin 6 parashikon ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, Ligji 9669/2006, i ndryshuar “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” parashikon, ndër masat e renditura në nenin 10, dëbimin e dhunuesve nga vendbanimi dhe marrjen e masave për sigurimin e viktims si dhe aktet ndërkombe të që garantojnë parimin e barazisë dhe ndalimin e diskriminimit, të cilat janë renditur më lart.

Lidhur me rastin në fjalë, referuar Kontratës tip mbi “*Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjare*”, konstatojmë se *mosmarrja e masave të përshtatshme për eliminimin e pabarazisë kontraktore në kuadrin e ofrimit të shërbimeve, vendos një precedent të rrezikshëm për të gjithë rastet e tjera kur bashkëshortët, apo edhe anëtarë të tjerë të familjes, mbështetur në cilësinë e kontraktuesit, përdorin mjete të paligjshme dhe abuzive për të ushtruar presion dhe dhunë psikologjike mbi bashkëshortin tjetër apo anëtar të tjerë të familjes, duke përdorur institucionet publike*.

³ Kodi i Familjes, nenin 2 parashikon shprehimisht se “*Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat, në vendimet dhe veprimtarinë e tyre, duhet të kenë si konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës*”

⁴ *Ligji 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, nenin 7 pika (2) parashikon se eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta, aktet ndërkombe të ratifikuara dhe ligjet në fuqi, ndërsa në nenin 20 e në vijim parashikohet ndalimin e diskriminimit në fushën e të mirave dhe të shërbimeve, konkretisht: 1. *Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: (a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; (b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*



PËR KËTO ARSYE

Duke patur parasysh se parashikimet e kontratës në lidhje me të drejtën ekskluzive të vetëm njërit prej ish-bashkëshortëve, si lidhës i kontratës, për të disponuar mbi lidhjen, ndërprerjen apo pezullimin e shërbimit të energjisë në banesën bashkëshortore, duke refuzuar të drejtën e ish-bashkëshortit tjetër përfituar nga shërbimi që ofrohet në banesën e përbashkët, ka potencialin e cenimit të të drejtave të bashkëshortëve për të pasur akses të barabartë në shërbime, të garantuara nga kuadri ligjor i brendshëm dhe ai ndërkomëtar.

Sa më lart, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, që parashikon shkaqet e diskriminimit dhe nga ku garantimi i parimit të barazisë gjinore hyn në objektin e këtij ligji, nenit 20 që ndalon diskriminimin në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, dhe nenit 32, pika 1 germa (f) ku parashikohet se “*Komisioneri ka kompetencë që të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*”:

ROKOMANDOJMË

1. Rishikimin e kontratës tip mbi “*Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë*”, duke parashikuar përkufizimin e “*klientit familjar*”, dispozita të qarta në përcaktimin e subjekteve të përfshihen në përkufizimin e “*klientit*” si dhe detyrimi për respektimin e tyre, po ashtu të rregullohet liria e “*klientit*”, si titullar i kontratës, për pezullimin/ndërprerjen e saj, me qëllim që të mos mohohet e drejta e furnizimit me energji elektrike e anëtarëve të familjes, për shkak të vullnetit abuziv të titullarit të kontratës.
2. Të mbahet parasysh rishikimi i akteve ligjore dhe nënligjore si dhe praktikat e deritanishme, me qëllim që ato të përputhen me parimin e barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, të sankzionuara në legjislacionin kombëtar në fuqi dhe aktet ndërkomëtare.

Në përputhje me nenin 33 pika 11 të Ligjit 10221/2010 “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”, lutemi që, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për masat e ndërmarra nga ana Juaj për zbatimin e këtij rekomandimi, brenda 30 ditëve nga data e dërgimit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al